



Nr. 02 Prot.

Tiranë 24/07/2023

Lënda: Mbi dërgimin e listës me emrat e anëtarit dhe anëtarit zëvendësues të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve

AKADEMISË SË SHKENCAVE
KRYETARIT
Z. SKËNDER GJINUSHI

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", ju informojmë se më datë 19.07.2023 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka publikuar shpalljen e vendeve vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve.

Avokati i Popullit ka filluar punën për ndjekien dhe zbatimin e procedurave të mëtejshme administrative, për zhvillimin e procesit, në përputhje me kompetencat dhe afatet e caktuara në ligjin e sipërcituar.


Referuar neneve 23 pika 1/ç dhe 121 pika 1/ç, në përbërje të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve është edhe një anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave nga shkencat shoqërore.

Për sa më lart, me qëllim krijimin e Komisionit Ad-Hoc në përputhje me nenet 23 e vijues dhe 121 e vijues të ligjit nr. 115/2016, ju drejtohem për të kërkuar nga ana juaj dërgimin e listës me emrat e anëtarit dhe anëtarit zëvendësues në përfaqësim të Akademisë së Shkencave që do të marrin pjesë në Komisionin e Pavarur *Ad Hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve. Ju sjellim në vëmendje se sipas procedurës dhe afateve të parashikuara në ligj, nevojitet që përfaqësuesit të jenë të disponueshëm edhe gjatë muajit Gusht 2023.

Në përputhje me pikën 4 të nenit 25 dhe pikën 4 të nenit 123 të ligjit nr. 115/2016 lutemi dërgimin e emrave të mësipërm brenda afatit ligjor 5 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,


AVOKATI I POPULLIT
Erinda BALLANCA
Erinda BALLANCA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Nr. 536/1 prot.

Tiranë, 28.7.2023

Lënda: Përgjigje letrës suaj të datës 24.7.2023, nr. 02 prot.

Për znj. Erinda Ballanca ✓

Avokati i Popullit

E nderuar znj. Ballanca,

Kryesia e Akademisë së Shkencave ju uron sukses e mbarësi në realizimin e detyrës suaj në përmbushje të detyrimeve të Ligjit nr. 115/2016 Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë.

Në përgjigje të kërkesës suaj për propozimin e një anëtari dhe të një anëtari zëvendësues si përfaqësues të Akademisë së Shkencave, nga fusha të shkencave shoqërore, në përbërje të komisionit të pavarur *ad hoc*, për vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të KLP dhe të KLGJ, në përputhje me nenin 23 pika 1/ç dhe nenin 121 pika 1/ç, ju njoftojmë se nga ky institucion propozohen akademikët:

1. Akad. Shaban Sinani (anëtar) [REDACTED]
2. Akad. asoc Adrian Civici (zëvendësues) [REDACTED]

Me respekt,

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

Në mungesë dhe me porosi

Akad. Vasil S. Tole

ZËVENDËSKRYETAR

